



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 21/1, datë 14.11.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin nëntor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 14:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 14.11.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin nëntor të Këshillit Bashkiak Durrës, të kërkuar nga kryetarja e bashkisë, e cila ka propozuar 5 projektvendime me relacionet përkatëse.

I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretarja e këshillit. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

35 këshilltarë në sallë.

(p.s Hyn me vonesë këshilltari J. Zaza dhe këshilltari P. Ismailati, pra 37).

Ani Dyrmishi : Faleminderit Dorina.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KATËRT PARAPRAKE TË 3 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHITËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONA VE TË REJA
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 3 shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 67, DATË 10.06.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR
Pika 4 shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 48, DATË 14.04.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR
Pika 5 shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 117, DATË 30.09.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR

Në lidhje me rendin e ditës ka komente nga ana këshilltarëve?

Nuk ka komente, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Përshëndetje.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe Komisioni ynë votoi unanimit për ta kaluar sot në votim pikën 1.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi unanimit për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 1, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 2**, i japim fjalën znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 2, komisioni pasi e mori në shqyrtim propozon unanimit për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë votoi unanimit për miratimin e këtyre ndryshimeve.

Ani Dyrmishi : Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 2, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 3, vendosi unanimsht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë pasi shqyrtoi materialet e vëna në dispozicion votoi pro këtyre ndryshimeve.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës ra dakort për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 4**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit të materialeve të dërguara nga bashkia, Komisioni ynë propozon unanimsht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu edhe Komisioni ynë votoi unanimit për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 36 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 5, Komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë votoi pro miratimit të këtij ndryshimi.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe Komisioni ynë vendosi pro kalimit në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit

Përsa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 5 dhe e fundit e rendit ditës.

Kryetare ke diçka për të shtuar?

Emiriana Sako : Jo, faleminderit .

Ani Dyrmishi: Faleminderit të gjithëve.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni në postën elektronike nga sekretaria e këshillit.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 6 (gjashtë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ (mungon)

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI